



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 164 Prot

Tiranë, më 12,12, 2011

**VENDIM Nr. 181, dt. 12.12.2011**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.12.2011 mbasi shqyrtoi çështjen për "Miratimin e procedurës për kryerjen e sërvejit arkeologjik në HEC-et, e Kaskadës së lumit Devoll",

**VENDOSI :**

- I. Të kryhet sërveji intensiv arkeologjik në HEC-et e Kaskadës së Lumit Devoll, HEC Banjë, HEC Moglicë dhe HEC Kokel.
- II. Sërveji intensiv arkeologjik për HEC Banjë do të realizohet nga grupi i punës i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe konsulencën shkencore të Institutit të Arkeologjisë (QSA).
- III. Sërveji intensiv arkeologjik për HEC-et Kokel dhe Moglicë do të realizohet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik duke nënkontraktuar individë dhe subjekte private të liçencuar për veprimtari arkeologjike dhe konsulencën shkencore të Institutit të Arkeologjisë (QSA).
- IV. Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore në MTKRS dhe ASHA të negociojnë me shoqërinë "Devoll Hydropower" sh.a për arritjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi në aspektin organizativ dhe financiar për realizimin e sërvejit.
- V. Afati kohor i realizimit të sërvejit intensiv arkeologjik do të jetë 90 ditë pune nga fillimi i aktivitetit në terren.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**ALDO BUMÇI**

**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**

**ROLAND OLLI**



Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: [sekretaria.teknike@asha.gov.al](mailto:sekretaria.teknike@asha.gov.al)